



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 4243 prot.

Himarë, më 09.06 2025

URDHËR

Nr. 335 Datë 09.06/2025

PËR

**“DISIPLINIMIN E QARKULLIMIT TË AUTOMJETEVE PËR FURNIZIMIN E
BISNESEVE/SUBJEKTEVE GJATË SEZONIT TURISTIK”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin Nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin 8378/1998 “Kodi rrugor i Republikë së Shqipërisë”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM-së Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, Udhëzimit të përbashkët Nr.7967/2018 “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin e mallrave përgjatë sezonit turistik” dhe VKB Himarë Nr.7 datë 11.02.2025 “ Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2025 dhe planit të veprimit përkatës”. Me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar pengesat dhe bllokimet si rrjedhojë e qarkullimit të rënduar gjatë sezonit turistik:

URDHËROJ:

- 1- Për periudhën 15.06.2025 deri më 15.09.2025 do të lejohet vetëm lëvizja e kontrolluar e mjeteve rrugore që shërbejnë për furnizimin me mallra të bizneseve/subjekteve në qendrat ku kryejnë aktivitetin ekonomik prej orës 05:00-10:00.
- 2- Fasha e orarit e parashikuar në pikën 1, do të jetë e detyrueshme në të gjithë vijën bregdetare të Bashkisë Himarë.
- 3- Subjektet furnizuese të marrin masa për kryerjen e aktivitetit të furnizimit brenda fashës orare të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhëri, për të krijuar mjedis miqësor me pushuesit vendas dhe të huaj.
- 4- Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Policisë Bashkiake Himarë, Drejtoria e Mbrojtjes së Territorit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ky urdhër hyn në fuqi më 15/06/2025.

KRYETARI

Vangjel Tavo

